

VENDIM
Nr. 171, datë 6.3.2012

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 532, DATË 7.7.2010 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR PJESEMARRJE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONE USHTARAKE, NË SHTABE TË
NDRYSHME NË AFGANISTAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të Drejtimit Strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 532, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi, si më poshtë vijon:

a) Në pikat 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6, pas fjalëve “... me rotacion 6 (gjashtë) muaj ...” shtohen fjalët “... së cilës i shtohet edhe periudha e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës ...”.

b) Në pikën 2, fjala “... mbivendosje ...” zëvendësohet me fjalët “... shpenzime për zhvillimin e aktiviteteve social - kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit ...”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha